 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
(Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>	<i>7</i>
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia vjetore	çmimi për njësi	Çmimi total per nje vit (3 x 4X)	Çmimi total per tre vjet	Afati
1.	Printime A4 Bardh e zi	25,000,000 faqe				3 vjet
2.	Printime A4 me ngjyra	1,500,000 faqe				
3.	Printim A0	60 rula				
	Çmimi total (Mallrat)					_____
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						

Vula		
Datë _____		

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Shërbimi i printimit për nevojat e OSHEE Group sh.a, për një periudhe 3 vjecare

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj sipas termave te references.

Sasia e mallit që kërkohet:

Volumet e printimit te parashikuara (1 vit).

Nr.	Përshkrimi	Sasia e Printimeve/A4
1	Printime A4 Bardh e zi	25,000,000 faqe
2	Printime A4 me ngjyra	1,500,000 faqe
3	Printim A0	60 rula

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Specifikimet teknike të hartuara:

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Kontrata: "Shërbimi i printimit" me afat 3-vjeçar

Shërbimi që kërkohet: Shërbimi i printimit për nevojat e OSHEE GROUP sh.a.

Kompania OSHEE sh.a, për të realizuar funksionalitetin e plotë të shërbimit të printimit/fotokopjimit/skanimit kërkon sasinë mëposhtme të pajisjeve:

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Printer black and white arketari	113 cope
2	Printer color	36 cope
3	Pajisje Multifunkcionale e mesme	112 Cope
4	Pajisje Multifunkcionale e vogël	248 Cope
5	Pajisje Multifunkcionale me ngjyra.	21 Cope
6	Pajisje Multifunkcionale format A0.	6
7	Software per monitorimin e pajisjeve	1
8	Software per manaxhimin e pajisjeve	1

Shënim: Sasia e pajisjeve është sasia e momentit dhe mund të ndryshojë në varësi të nevojave të OSHEE Group sh.a. Sasia e pajisjeve të shtuara nuk mund të jete me shume 20% e totalit të kërkuar për të gjithë pajisjet (pa kosto shtese).

1. Volumet e printimit te parashikuara (1 vit).

Nr.	Përshkrimi	Sasia e Printimeve/A4
1	Printime A4 Bardh e zi	25,000,000 faqe
2	Printime A4 me ngjyra	1,500,000 faqe
3	Printim A0	60 rula

- Në çmimin e dhënë duhet të përfshihen te gjitha pjesët konsumuese, pjesët e këmbimit, toneri dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe software.
- I gjithë sistemi i printimit te menaxhohet nga ofruesi i shërbimit dhe çdo lajmërim për defekte duhet të bëhet në mënyrë automatike pa ndërhyrjen e operatorëve.
- Toner-at duhet te ndërrohen në mënyrë proaktive nga ofruesi i shërbimit. Ofruesi i shërbimit duhet të lajmërohet paraprakisht ne momentin qe toneri është duke mbaruar dhe duhet te zëvendësohet me toner te ri pa e ndërprerë shërbimin e printimit.
- Pagesa do të kryhet në bazë të faqeve të printuara/fotokopjuara.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose broshurë për mallin që oferton. Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specififikimet teknike të produktit të ofertuar.
- Pajisjet do te vendosen ne ambientet e Drejtorisë e Qendrore te OSHEE GROUP sh.a, degëve dhe zyrave në të gjithë territorin e vendit (lista e vendndodhjeve, pikave të kontaktit dhe detajet plotësuese do të vihet në dispozicion për operatorin fitues).
- Shërbimi me të gjithë komponentët e tij duhet te implementohet brenda 15 ditësh kalendarike nga firmosja e kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të përgjigjet sipas tabelës se mëposhtme për problemet që shfaqen gjatë procesit të punës (SLA).

Nr.	Përshkrimi	Ndërhyrja	Zgjidhja e problemit pas ndërhyrjes	Total për zgjidhjen e një problemi	Oraret e punës
1	Qarku i Tiranës	50 minuta	20 minuta	70 minuta	E Hënë E Dielë 08:00 – 21:00
2	Qytetet me pak se 100 km nga Tirana	120 minuta	20 minuta	140 minuta	E Hënë E Dielë 08:00 – 21:00
3	Qytetet mbi 100 km nga Tirana	180 Minuta	30 minuta	210 minuta	E Hënë E Dielë 08:00 – 21:00

- Operatori ekonomik duhet të faktojë teknikisht si do mund të përmbushë kriteret e SLA, në të kundërt konsiderohet si kusht për skualifikim.

11. Printer bardhë e zi arkëtari

Teknologjia	Laser/B&W
Shpejtësia A4	55 faqe/min
Cikli Mujor i Punës	Min 250,000 Faqe
Rezolucioni i printimit	Min 1200 dpi
Kapaciteti hyrës i letrës	Min 600 flete
Kapaciteti hyrës i letrës max	Min 2600 flete
Kapaciteti ne dalje	Min 500 flete
Formati i printimit	A4-B6
Memoria (RAM)	Min 512 MB
Mënyra e lidhjes	Ethernet, USB
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po

12. Printer me ngjyra

Teknologjia	Laser/Color
Shpejtësia A4	30 faqe/min
Cikli Mujor i Punës	Min 100,000 Faqe
Rezolucioni i printimit	Min 600 x 600 dpi
Kapaciteti hyrës i letrës	Min 600 flete
Kapaciteti hyrës i letrës max	Min 2100 flete
Kapaciteti ne dalje	Min 250 flete
Formati i printimit	A4-B6
Memoria (RAM)	Min 512 MB
Mënyra e lidhjes	Ethernet, USB
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po

13. Pajisje Multifunksionale e mesme

Printer	
Teknologjia	Laser/Color
Shpejtësia A4	≥30 faqe/min

Cikli Mujor i Punës	Min 100,000 Faqe
Rezolucioni i printimit	Min 600 x 600 dpi
Kapaciteti hyrës i letrës	≥600 flete
Kapaciteti hyrës i letrës max	≥2000 flete
Kapaciteti ne dalje	≥250 flete
Formati i printimit	A4-B6
Memoria (RAM)	Min 512 MB
Mënyra e lidhjes	Ethernet, USB
Printimin në të dyja anët (Duplex)	Po

14. Pajisje Multifunksionale e vogël

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Laser
Shpejtësia A4	≥28 faqe/min
Shpejtësia A3	≥14 faqe/min
Rezolucioni i printimit	2400 x 600 dpi
Kapaciteti hyrës i letrës	≥300 flete
Kapaciteti ne dalje	≥100 flete
Formati i printimit	A5-A3
Memoria (RAM)	Min 512 MB
Mënyra e lidhjes	Ethernet, USB, Wireless(Opsional)
Skanimi	Full Network Color Scan (Scan to e-mail, Scan to FTP, Scan to USB)
Shpejtësia Skanimit	≥25 ipm
Rezolucioni i Skanimit	Min 600 dpi
ARDF	≥50 fletë
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po

15. Pajisje Multifunksionale e mesme

Fotokopje/Printer/Skaner	

Teknologjia	Laser
Ekran	Min 9" me ngjyra dhe prekje
Shpejtësia A4	≥32 faqe/min
Shpejtësia A3	≥17 faqe/min
Rezolucioni i printimit	1200 x 1200 dpi
Kapaciteti hyrës i letrës	≥1100 flete
Kapaciteti hyrës i letrës max	≥4000 flete
Kapaciteti ne dalje	≥300 flete
Kapaciteti ne dalje max	≥3000 flete
Formati i printimit	A6-A3
Memoria (RAM)	2 GB
Hard Disk	32GB SSD
Mënyra e lidhjes	Ethernet, USB, Wireless(Opsional)
Skanimi	Full Network Color Scan (WSD Scan, Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, Scan to USB)
Shpejtësia Skanimit	≥80 ipm
Rezolucioni i Skanimit	Min 600 dpi
ARDF	≥50 flete
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po

16. Pajisje Multifunksionale me ngjyra

Fotokopje/Printer/Skaner	
Teknologjia	Laser/Color
Ekran	Min 9" me ngjyra dhe prekje
Shpejtësia A4	≥40 faqe/min
Shpejtësia A3	≥20 faqe/min
Rezolucioni i printimit	4800 x 1200 dpi
Kapaciteti hyrës i letrës	≥1100 flete
Kapaciteti hyrës i letrës max	≥7000 flete
Kapaciteti ne dalje	≥500 flete

Kapaciteti ne dalje max	≥4000 flete
Formati i printimit	A6-A3
Memoria (RAM)	4 GB
Hard Disk	8GB SSD
Mënyra e lidhjes	Ethernet, USB, Wireless(Opsional)
Skanimi	Full Network Color Scan (WSD Scan, Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, Scan to USB)
Shpejtësia e Skanimit	≥180 ipm
Rezolucioni i Skanimit	Min 600 dpi
ARDF	≥260 flete
Printimin ne të dyja anët (Duplex)	Po

17. Pajisje Multifunkionale format A0

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Teknologjia	Inkjet/Color
Format	A0
Teknologjia "Technology":	Inkjet
Rezolucioni "Print Resolution"	Min 2400dpi x 1200dpi
Saktësia e linjës	±0.1
Pesha minimale e linjës	0.02mm
Numri i Nozzles	Black: 5,120 Nozzles Color: 2,560 Nozzles/Color
Nozzle Pitch (Head Resolution)	2x1200dpi
Printer RAM (Fizik)	Min 2GB
Hard Drive	Min 500 GB
Media Feed	Roll - Front-loading & Output
Media Width	8"-36"
Printable Margins	0-0.12"
Maximum Print Length	Roll Feed: 59", Cut Sheet: 63"
Borderless Printing Width	8", 10", 12", 14", 16", 17", 20", 24", 30", 36"
Trashësia e medias	0.07 – 0.8 mm

Diametri maksimal i rulit të jashtëm	Min 170 mm
Gjuha Printimit “Print Language”	SGRaster, HP-GL/2, HP RTL, PDF, JPEG
Porta e komunikimit “Interface”:	USB 2.0 Hi-Speed;10/100/1000 Base-T/TX

18. Software për monitorimin e pajisjeve.

Software për monitorimin e pajisjeve të printimit	
1	Monitorimin e statusit të pajisjeve në kohë reale duke përdorur protokollet SNMP.
2	Menaxhimin dhe konfigurimin e pajisjeve në mënyrë të centralizuar.
3	Raportim me email për sasinë e printimeve të gjithë pajisjeve apo një grupi të tyre.
4	Ruajtja e raporteve në server në mënyrë periodike (ditore, javore, mujore, vjetore).
5	Dërgimi i emaileve automatike në rast të shfaqjes së problemeve teknike.
6	Dërgimi i emaileve automatike që tregon statusin e tonerit dhe lajmërimi për ndërrimin e tij në mënyrë proactive.
7	Krijimi i raporteve për sasinë e printimeve, fotokopjimeve, skanimeve për secilën pajisje.
8	Software duhet të ruajë në database të gjithë aktivitetin e pajisjes dhe të mundësojë krijimin e raporteve mbi bazë pajisjesh apo grupi pajisjesh. Krijimin e raporteve për kohën që pajisjet kanë ndërruar pa punë për arsyt e problemeve teknike, krijimin e raporteve për kohën e shfaqjes dhe zgjidhjes së një problemi teknik dhe shpjegimin e natyrës së problemit të shfaqur.
10	Aplikacion Android dhe IOS për monitorimin e statusit të pajisjeve dhe lidhja e tij me software.
11	Mundësimi për upgrade automatic me anë të software të versioneve të fundit të firmware të pajisjeve.
12	I gjithë sistemi duhet të jetë automatik dhe të monitorohet nga një qendër e vetme.

19. Software për menaxhimin e pajisjeve.

Software për menaxhimin e pajisjeve të printimit	
1	Krijimi i profileve të ndryshme të printimit, skanimit me anë të software dhe shpërndarjen e konfigurimit të të gjitha pajisjet, një grup apo disa pajisje në mënyrë automatike.

2	Menaxhimin e pajisjeve me usera (nëse kërkohet) dhe konfigurimet përkatëse në mënyrë të centralizuar.
3	Akses në pajisje nëpërmjet PIN, Log in me ID-Card ose kredenciale Windows për përdoruesit në Zyrat Qendrore dhe pikat me DMVPN.
4	Printim i sigurtë dhe enkriptim i të dhënave.
5	Funksioni Print&Follow në mënyrë që dokumentat të jenë të aksesueshme dhe të printueshme vetëm nga personat e autorizuar në pajisjet e autorizuara.
6	Statistika të detajuara mbi printimin, fotokopjimin dhe skanimin të cilat të gjenerohen sipas projektit, përdoruesit apo departamentit në mënyrë manuale dhe automatike.
7	Shfaqjen e ndërfaqeve të përdoruesit ose të grupit për të kryer detyra bazuar në nevojat të atij përdoruesi apo grupi.
8	Funksioni skanimi me anë të një klikimi. Gjithashtu mundësia e zgjidhjes në destinacionet e lejuara, si folder privat ose grupi, me qëllimin e rritjes së efikasitetit dhe automatizimit të punëve.
10	Mundësia për të çuar detyrën e printimit nëpërmjet email tek serveri i printimit dhe printimi fizik në të gjithë flotën e printimit të lejuar të përdoruesit.
11	Suport për të printuar nëpërmjet aplikacioneve native për iOS dhe Android, si dhe për të skanuar nga pajisja mobile.
12	Mundësia për të vendosur kuota për përdorues ose grup përdoruesish ose projekt.
13	Integrimi i i OCR.
14	Autentikim offline – në rast se rrjeti i OSHEE ka probleme.
15	Mundësia për të simuluar në rrjet lokal rolin e serverit, për vendndodhjet, të cilat nuk kanë server, në mënyrë që të monitorohet printimi pa patur nevojën e një serveri.
16	Suport për print nga Windows, Linux, MAC OS, dhe SAP.
17	Monitorim dhe gjurmim i plotë i printimit.
18	Funksionaliteti i printimit të deleguar në mënyrë që drejtorët të kenë mundësi të delegojnë printimet të asistentet e tyre.
19	Mundësia për të forcuar printim duplex në grupe përdoruesish apo grupe pajisjesh, për të forcuar printim BW apo A4.
20	Mundësia për të arkivuar të gjithë printimet e përdoruesve në një sistem të tretë.
21	Mundësia për printim të drejtpërdrejtë, pa patur nevojë autentikimi, për përdorues të caktuar.
22	Mundësia për të forcuar politika të ndryshme mbi printimin, fotokopjimin, dhe skanimin mbi përdorues, pajisje ose grupe të tyre.
23	Software duhet të ketë dhe një ndërfaqe në web për të aksesuar sistemin.
24	Software duhet të suportojë konfigurimin në cluster për të siguruar disponibilitet të lartë të shërbimit.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

-
- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **116,700,000 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind mijë)** leke pa TVSH.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 46,600,000 (dyzet e gjashtë milion e gjashtëqind mijë) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumatat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:

- a) **ISO 9001:2015** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- b) **ISO 27001:2022** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);
- c) **ISO/IEC 20000-1:2018** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit (e vlefshme);
- d) **ISO 14001:2015** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit mjedisor (e vlefshme)

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në të paktën 8 (tetë) qarqe të vendit, pika servisi për të siguruar shërbim dhe mirembajtje në kohe. Vertetuar kjo me QKB ku të figurojnë si adresa sekondare në keto pika.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 14 punonjës nga të cilët duhet të ketë një numër prej 8 (tetë) inxhinierë të diplomuar në degët e ne fushen e informatikes, elektrike, mekanike, elektronike, fizike, teknologji informacioni, ose mekatronik që do të angazhohen në implementimin e projektit. Kjo të vertetohet me dorëzimin *Listepageses të dorëzuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente, për muajin e fundit të maturuar*, kontratave të punes, diplomat dhe CV perkatese të specialisteve.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të vertetojë se ka të punësuar për të paktën muajin e fundit stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar për suportimin dhe implementimin e zgjidhjeve të kerkuara.

Specialistet e servisit duhet te jene te pajisur me certifikata nga prodhuesi qe verteton aftesine e tyre per riparimin e paisjeve te printimit, implementim dhe konfigurime te softwareve te kerkuar si dhe te gjithë shërbimit te nevojshem.

Specialiste te servisit do te konsiderohen vetem ata qe jane te pajisur me vertetim nga prodhuesi:

- a. Te paktën 1 (nje) Project Manager të certifikuar për te menaxhuar shërbimin gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.
- b. Te paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për printer BW (black-white) të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kontratës.
- c. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për MFP (multifunction printer – all-in-one) te Vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kontratës.
- d. Te paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për MFP (multifunction printer – all-in-one) te Mesme të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.
- e. Te paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar per MFP (multifunction printer – all-in-one) Color te ofertuar per te implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kontratës.
- f. Të paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar për software monitorimi te ofertuar për të implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjatë kontratës.
- g. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për software menaxhimi te ofertuar për të implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjatë kontratës.
- h. Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel Associate “CCNA” për Routing dhe Switching për te implementuar dhe integruar me zgjidhjen ekzistuese Cisco Networking për te gjithë pajisjet në të gjithë vendin.
- i. Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel MCSE ose ekuivalente për Infrastruktura për te gjithë konfigurimet e nevojshme te sistemit software ne infrastrukturën e serverave te OSHEE.

Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikate.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per te paktën muajin e fundit nga data e hapjes se tenderit.

Nje punonjes mund te kete me shume se nje certificate dhe per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:

- *Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm;*
- *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjeter vertetues, per muajin e fundit nga data e hapjes se tenderit;*

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

- 2.3.6 Autorizimin e kompanisë prodhuese/distributorit të autorizuar (ku të provohet lidhja e distributorit me prodhuesin) drejtuar OSHEE që operatori ekonomik ekonomik është i autorizuar të tregtojë në territorin e Shqipërisë, markën e pajisjes dhe software që oferton.
- 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 10 (dhjetë) mjete transporti mallrash, me qëllim transportin e mallit dhe krijimin e mundësisë të levizjes së specialisteve për të dhënë shërbimin në kohë në të gjithë territorin ku janë të vendosura zyrat e OSHEE GROUP sh.a dhe bijave, të cilat duhet t’i ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Leje qarkullimi e mjetit.
- b) siguracion i mjetit.
- c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

Sqarim : Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

- 2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht 50% e sasisë së paisjeve të ofertuara në stok për të garantuar implementimin e shërbimit brenda afateve të kërkuara. Për vërtetimin e stokut duhet të derghohen modelet dhe numrat serial të paisjeve sipas faturave të blerjes/deklarate doganore. Komisioni i vlerësimit të ofertave mund të bëjë verifikim në magazinat e operatoreve ekonomik për të vlerësuar nëse ky kriter është plotësuar.
- 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose broshurë nga prodhuesi për mallin dhe software që oferton. Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të produktit të ofertuar.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet te faktoj teknikisht si do arrij te permbushe kriteret e SLA. Duhet te prezantohet forme e reagimit ne rast problemesh si dhe ku jane te stacionuara qendrat e mbeshtetjes teknike, si do mundesohet ofrimi i sherbimit brenda kohes se kerkuar ne skajet e vendit...etj (plan organizimit, kontrata bashkepunimi etj).

Shenim : sqarojme te gjithë operatorët ekonomik qe ne rast mosperputhje ndermjet versionit anglisht te DT dhe atij ne shqip, do te prevalojë versioni shqip i DT.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i vecantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

- I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

